



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani Elezit

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Bazuar në rregulloret në fuqi dhe në statutin e komunës së Hanit të Elezit neni 77, ku me këtë nen është e përcaktuar veprimtaria e kësaj drejtorie, ku për këtë drejtori ne kemi planifikuar punët dhe detyrat janar – dhjetor 2011.

Ne si drejtori do të përqendrohemi :

- Së pari, në plotësimin e stafit të kësaj drejtorie,
- Së dyti, krijimi i kushteve të volitshme për stafin, dhe
- Së treti, shtimin e efikasitetit të punës në këtë drejtori.

Struktura organizative e drejtorisë (skema)

Drejtori i drejtorisë së DSHPE-së (1)
Shërbimi i zjarrfikësve dhe shpëtimit (5+1)

Buxheti i planifikuar i drejtorisë për vitin 2011 është:

-Paga dhe mëditje.....	34,540.00 €
- <u>Mallra dhe shërbime.....</u>	<u>12,071.00 €</u>
-Gjithsejtë buxheti	46,611.00 €

Objektivat

- **Institucionalizimi i shërbimeve publike në nivel komune**
- **Shtimi i orarit të punës për njësinë e zjarrfikësve**
- **Ngritjen e kapaciteteve vepruese në njësinë e zjarrëfiksive**
- **Menaxhimi i ujësjellësit dhe përmirësim i cilësisë**

Aktivitetet:

- Ngritjen e kapaciteteve në DSHPE
- Institucionalizimi i shërbimeve publike
- Formimin e sektorit të ndërmarrjes publike lokale:-
- Koordinatori :
 - a) Përgjegjësi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit
 - b) Përgjegjësi i mirëmbajtjes së mbeturinave
- Për vitin 2011 në mesin e shumë objektivave të planifikuara, si më prioritet do të jenë:
- Përbushja e të gjitha obligimeve legjislative që rrjedhin nga dispozitat ligjore të nivelit qendror, komunal dhe nga statuti i miratuar i komunës sonë, në përgatitjen dhe hartimin e dispozitave ligjore si dhe në zbatimin e tyre.
- Reagim të shpejt dhe efikas të ekipeve emergjente, si të nivelit lokal edhe të atij qendror qeveritar ndaj rasteve emergjente , si: zjarreve të ndryshme , aksidente komunikacioni, aksidente teknologjike dhe fatkeqësi natyrore.
- Rritja e kapaciteteve të filtrave me qëllim të rritjes së sasisë së ujit dhe funksionalizimin e ujësjellësit të Dimcës.
- Hartimin e planit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
- Formimin e ekipeve vullnetare kundër zjarrit gjatë muajve të verës, kur në ato kohë temperaturat e larta të nxehtësisë mund të shkaktojnë ndezje dhe përhapja e zjarreve.
- Ngritja e vetëdijesimit për mbrojtje nga zjarret, për qytetaret me anë të :- bisedave me qytetaret dhe broshurave.
- Vazhdimi i bashkëpunimit me Community Development Initiatives CDI me fazën e –IV- të investimeve.
- Vazhdimi i bashkëpunimit me Swiss Kosovo Local Governance and Decentralization Support LOGOS.

Përgjigje ndaj emergjencave të mëdha duke i realizuar me sukses :-

Alarmimin dhe informimin e popullatës

Kërkim - shpëtimin

Evakuimin

Strehimin dhe

Dhënien e ndihmës mjekësore dhe humanitare

Shtimi i efikasitetit në koordinimin e punës në raste emergjente me :

- Policinë e Kosovës (SHPK)
- KFOR-in
- Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK)

Krijimin e një ambienti të pastër dhe të qetë në bashkëpunim me kompanitë që kontrahohen nga Komuna jonë.

Përmirësimin e infrastrukturës së komunikacionit duke krijuar kushte më të volitshme në trafikun rrugor të Hanit të Elezit.

Përmirësimin e rrjetit të kanalizimit dhe të ujësjellësit.

Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit – emergjentë

Siç dihet se ne kemi nën udhëheqje shtëpinë e zjarrfikësve, ku me këtë staf nuk kemi mundësi të organizojmë ndërrim kujdestar emergjent, kjo është mungesë e stafit nga lejimi i ministrive përkatëse për punëtor (MEF dhe MPB). Ne në SHZSH në Han të Elezit nuk kemi Autocisternë funksionale, autocisterna që e disponon shërbimi i zjarrfikësve është shumë e vjetër dhe nuk ka mundësi të organizohet puna e suksesshme në SHZSH pasi që mjet kryesorë për zjarrfikëset është autocisterna. Ne si drejtori në bashkëpunim me kryetarin e komunës dhe me kuvendin komunal të Hanit të Elezit do të mundohemi të sigurojmë një autocisterne funksionale për shërbimin e zjarrfikësve.

Në mos rritjen e stafit për SHZSH-së dhe mos posedimit e një autocisternë të re, ne do të mundohemi që brenda mundësive që i kemi të jemi sa më funksional në kryerjen e detyrave dhe obligimeve si drejtori.

Do të hartojmë planin komunal për mbrojtjen nga zjarri dhe vlerësimin e rrezikut për komunën tonë.

Reagimet emergjente në parandalimin e krizave, shuarjen e zjarreve, vërshimeve si dhe të të gjitha fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Do të bëhen në mbështetje të akteve normative dhe dokumenteve:

- Ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera (FNFT).
- Ligjit për mbrojtje nga zjarri.
- Statuti i Komunës.
- Plani i vlerësimit të rrezikut të Komunës së Hanit të Elezit
- Plani i reagimit emergjent.

Urdhëresave dhe qëndrimeve të organeve të Komunës së Hanit të Elezit

Kontrollime dhe inspektime nga zyrtari parandalues për marrjen e masave parandaluese ndaj zjarrit në objekte të rëndësishme të veçantë në komunën tonë.

Përcjellja e trajnimeve të ekipeve të shpëtimit të shërbimit të zjarrfikësve dhe shpëtimit, sipas Ligjit ne fuqi.

Sektori për mbrojtje dhe shpëtim në nivel të lartë gatishmërie, të shërbimit të zjarrfikësve dhe shpëtimit për intervenime ndaj zjarrit dhe formimi i njëjësive vullnetare për shpëtim nga zjarret dhe fatkeqësi natyrore konforme ligjit për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera.

Përgjigjja në të gjitha llojet e kërkesave nga personat fizik dhe juridik

Ne drejtorinë e shërbimeve publike dhe emergjencë vijnë shumë lloje të ndryshme të kërkesave. Nga kërkesat me shkrim të cilat do ti kemi, janë kërkesa për kyçje në sistemin e ujësjellësit dhe të ndryshme.

Ndalimi i të gjitha veprimeve të cilat bijën ndesh me ligjet dhe rregulloret e DSHPE-së
Trajtimi dhe ndalimi i kyçjeve ilegale në ujësjellës të cilët janë asete të komunës së Hani i Elezit. Të gjitha kyçjet ilegale në Han të Elezit, do të trajtohen duke u bazuar në rregulloren e ZRRUM-it dhe rregulloret e komunës së Hanit të Elezit.
Drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencë është e vendosur në ndalimin çfarëdo kyçje ilegale në ujësjellës apo veprimet të cilat janë në kundërshtim me rregulloren e kësaj drejtorie.

Bashkëpunimi i drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencë

Drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjence, nuk është e kompletuar me staf dhe pajisje tjera siç e kemi potencuar edhe në brendi të planit të punës, ne do të bashkëpunojmë me kryetarin(ekzekutivin) e komunës për realizimin e planeve të drejtorisë në fjalë.

Do të bashkëpunojmë me ministrinë përkatëse(MPB), përkatësisht departamentin e emergjencës civile të Kosovës (DECK).

Do të bashkëpunojmë me drejtorit e tjera komunale për të marrë ide dhe plane për zhvillim të komunës në drejtorinë e shërbimeve publike, në veçanti me drejtorinë shërbimeve publike dhe emergjence të komunës së Kaçanikut.

Do të bashkëpunojmë me qeverinë e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare për të siguruar një autocisternë, pasi që çmimi i një autocisterne është shumë i lartë.